

Njoftim rreth IBAN

Klientë të nderuar

Ju informojmë se duke filluar nga data 1 shkurt 2015 standardi IBAN (International Bank Account Number/ Numri ndërkombëtar i llogarisë bankare,) do të fillojë të zbatohet në Republikën e Kosovës.

Standardi IBAN do të aplikohet vetëm për pagesat ndërkombëtare.

Aplikimi i IBAN-it do të përmirësojë efikasitetin dhe cilësinë e realizimit të transfereve ndërkombëtare.

Çfarë është IBAN

IBAN është një numër i caktuar për një llogari bankare të klientit në përputhje me numrin e standardeve ISO 13616

Deri në Janar 2015 IBAN përdoret në 66 vende, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të BE-së .

IBAN-i në Kosovë

Zbatimi i IBAN-it në Kosovë është përcaktuar me Rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës për Sistemin e Numrave Standard të Llogarive Bankare .

Llogaritë e bankave vendore, për nevoja të transaksioneve ndërkombëtare, do të konvertohen në formatin IBAN me 20 karaktere alfanumerike.

Nga data 1 shkurt 2015 të gjitha pagesat ndërkombëtare do të bëhen nga llogaritë e klientëve në formatin IBAN.

Përgjegjësia e klientëve

Nga 2 shkurt 2015:

- Çdo llogari e klientëve (ekzistuese ose e re), e cila pranon / dërgon pagesa ndërkombëtare do t'i gjenerohet IBAN -i që korrespondon me llogarinë e tij
- Ju duhet t'i njoftoni partneret tuaj mbi IBAN-in e llogarisë tuaj bankare dhe SWIFT kodin e bankës.

Luteni të kontaktoni Degën më të afërt të bankës për gjenerimin e IBAN-it të llogarisë tuaj dhe SWIFT Kodin e bankës ose të vizitoni faqen tonë të internetit, ku për lehtësimin tuaj mund të gjeni [IBAN konvertuesin](#).